



Pranuar / Dorezuar Priljenoi/Prilidato Received/Delivery	29.12	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
KDNSHC	6418/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.897/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 01.11.2021 me numër A.nr.897/2021, e parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Lulan Haradinaj", Policia e Kosovës në Prishtinë –DPP, kundër Vendimit të datës 19.10.2021 me nr. i lëndës: KDNSHC-05/045/2021 të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa numër A.nr.897/2021 e datës 01.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me nr. lëndës:KDNSHC-05/045/2021 i datës 19.10.2021 i Komisionit Disiplinor i Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i sistemuar në pozitë "Inxhinier i makinerisë", në Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve-DPP në Prishtinë, me datë 15.06.2021 me Vendimin me nr. ref: 08-05-224-DMO/21, është caktuar kryesues në komisioni për inspektim për mbështetjen e detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorisë të Menaxhimit të Objekteve të Policisë Kosovës, i nxjerr nga Majorja Drejtore e Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve. Me datë 20.09.2021 është iniciuar procedurë disiplinore nga Drejtori i Menaxhimit të Objekteve të Policisë Kosovës - DSHM, për shkak dyshimit se ankuesi ka bërë shkelje të rënd të detyrave të punës, me rastin e mos kompletimit të certifikatës për pranimin teknik të inspektimit, nga kryesuesi i komisionit që lidhet me raportin (certifikatë) e inspektimit e cila nuk është nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit, sipas Kontratës së lidhur në mes të Policisë së Kosovës si Autoritet kontraktues dhe N.T.N. BESE COM si Operator Ekonomik, për vazhdimin e mbulojës së PKK, Hani të Elezit nr.PK:214/20/036/521, për të cilën Drejtori i Menaxhimit të Objekteve të Policisë, me datë 04.08.2021 ka kërkuar nga komisioni që të koordinohen dhe të dalin në inspektim të përpilojnë certifikatën e inspektimit final dhe të nënshkruhet nga tre anëtarët e

komisionit, sepse dy raportet që janë prezantuar në zyrën e tij, nuk janë nënshkruara nga tre anëtarët për të cilin raport anëtarja ka dhënë vërejtje në raportin e ankuesit.

Komisioni Disiplinor në Policinë e Kosovës, pasi ka pranuar iniciimin e procedurës disiplinore e ka pezulluar punën e tyre, me arsyetimin se njëri nga anëtarët e komisionit ka qenë i infektuar me covid-19 dhe me datë 19.10.2021 ka nxjerrë Vendimin me nr. lëndës:KDNSHC-05/045/2021, me të cilin ankuesit i shqipton masën disiplinore **“Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për dy(2) muaj”**.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 19.10.2021 me numër nr. lëndës:KDNSHC-05/045/2021, ka parashtruar ankesë me datë 01.11.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se vendimi si i tillë është i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.11.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 24.11.2021 ka përcjell dokumentacionin lidhur me këtë lëndë dhe provave shtesë të datës 15.12.2021.

Me datë 15.12.2021 Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 6140/21, me të cilin ka miratuar kërkesën e Kryetarit të Kolegjit, për shtyrjen e afatit të ankesës A.nr.897/2021, konform dispozitave ligjore në fuqi, duka pasur parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: **Ankesë e ankuesit** A.nr.897/2021 me numër protokollit 5222/2021 të datës 01.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë e datë 26.02.2021 e lidhur në mes të Policisë së Kosovës, si Autoritet kontraktues dhe N.T.N. BEI COM si Operator Ekonomik, për vazhdimin e mbulojës së PKK Hani Elezit nr.PK:214/20/036/521, deklarata e garantuar “ELSIG”, e datës 26.02.2021, Policë e sigurimit të garancisë së tenderit dhe ekzekutimit të kontratës e datës 26.02.2021; Vendimin me nr.ref 08-05-224-DMO/21 i datës 15.06.2021; E-mail i datës 22.06.2021 Inspektimi preliminar i PKK, Hani Elezit, E-mail i datës 24.06.2021 raport nga inspektimi i bërë në pikën kufitare Hani Elezit;Email i datës 30.06.2021, për raportin e inspektimit; E-mail i datës 25.06.2021 për vërejtjet; E-mail i datës 24.06.2021 gjatë inspektimit; Memorandum zyrtar-Drejtoria për menaxhimin e objekteve-certifikatë e inspektimit final; E-mail Raport i datës 14.07.2021; Drejtoria për menaxhimin e objekteve certifikatë e inspektimit e datës 14.07.2021; E-mail Raport i datës 04.08.2021; E-mail Raport i datës 14.07.2021, kërkesë për sqarim, informim; E-mail Njoftim i datës 02.09.2021; E-mail Kërkesë e datës 03.09.2021; E-mail i datës 13.07.2021 Raporti; E-mail Njoftim i datës 02.09.2021 E-mail Njoftim i datës 10.09.2021; E-mail Kërkesë e datës 21.09.2021; E-mail Kërkesë e datës 23.09.2021; E-mail Kërkesë e datës 22.09.2021; Vendimin me nr. lëndës:KDNSHC-05/045/2021 i datës 19.10.2021 i Komisionit Disiplinor Policia e Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 24.11.2021 me numër protokollit 5618/2021 nga Policia e Kosovës, Formulari i paraqitjes së disiplinës së brendshme i datës 09.09.2021;Kërkesë E-mail i datës 09.09.2021; Vërejtje E-mail i datës 08.09.2021; Vendimi i datës 15.06.2021; Raport - Drejtoria për menaxhimin e objekteve-certifikatë e inspektimit e datës 14.07.2021; Njoftim E-mail i datës 06.09.2021; Njoftim E-mail i datës 30.08.2021; Njoftim i datës 01.09.2021 E-mail; Njoftim i datës 23.08.2021 E-mail, forma për pranimin teknik të përkohshme të punimeve; Prova shtesë me dt.15.12.2021; E-mail i datës 14.12.2021; Vendimi mbi themelimin e komisionit disiplinor i datës 09.02.2021, i ndryshuar me vendimin nr.095 i datës 05.05.2021; Kontratat e punës e datës 11.09.2015; Kontratat e punës e datës 14.01.2014; Kontratat e punës e datës 02.05.2020; dy Formular për vlerësimin



e rezultateve në punë(pa data): Kontratat e punës e datës 06.11.2012; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 04.09.2015;Vendimi i datës 15.12.2021 për vazhdim të afatit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi i datës 19.10.2021 me numër nr. lëndës:KDNSHC-05/045/2 i nxjerrë nga Komisionit Disiplinore i Policisë së Kosovës, është i kundërligjshëm dhe jo objektiv, i njëanshëm duke pretenduar që ta anulohet Vendimi i datës 19.10.2021, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore **“Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për dy(2) muaj”**, sepse sipas ankuesit është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi i Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës me numër nr. lëndës: KDNSHC-05/045/2, të datës 19.10.2021, është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Sipas inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me datën 20.09.2021, i cili kishte iniciuar procedurë për kryesuesin e caktuar në komisionin për inspektim i themeluar me Vendimin me nr.ref: 08-05-224-DMO/21 të datës 15.06.2021 për kontratën “Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani Elezit” me nr. prokurimi 214/20/036/521. Mbi këtë bazë Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 19.10.2021, ku është intervistuar ankuesi ndaj të cilit me datën 20.09.2021 është iniciuar procedurë disiplinore në bazë të përgjegjësisë së tij, si kryesues i komisionit për inspektim i themeluar me vendimin e datës 15.06.2021 me nr.ref.08-05-224-DMO/21 për inspektimin e kontratës “Vazhdimi i mbulojës në PKK Hani i Elezit” me nr. të prokurimit 214/20/036/521”, të cilin e ka themeluar Drejtori i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve, për shkak të mos përmbushje të detyrave të dhëna me vendimin e lartë cekur.

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi pa ndonjë arsye ligjore apo faktike nuk ka përfunduar punën për të cilën është caktuar në Komision lidhur me inspektimet e punës në Objektivin e Stacionit në Kontratën me titull “Vazhdim i Punëve në Han të Elezit” me nr. Prokurimi. 214/20/036/521, në të cilin Komision ankuesi ka qenë i caktuar Kryetar, ku i njëjti në asnjë moment nuk ka arritur ta koordinoj punën e këtij Komisioni. Për shkak se ky Komision nuk ka përfunduar punën e tij dhe siç shihet nga shkresat e lëndës Kryesuesi i komisionit ka qenë pengesë, Drejtoria e Policisë për Menaxhimin e Objekteve është detyruar që t themeloj një komision na bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Brendshme me qëllim të përfundimit të kontratës së lartshënuar, prandaj Kolegji konstaton e ankuesi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore si vijon nenit 46 paragrafin 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3, si dhe nenit 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se : neni 46 paragrafi 3. **“Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës;” 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale ‘’, neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ‘‘ 1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë:..... 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj’’, si dhe nenit 8 paragrafi 3 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se **“3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2, dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri te 3.11 të Ligjit”**,**



në rastin konkret nëpunësi civil në cilësinë e kryetarit të komisionit ka dështuar në përmbushjen e detyrave të dhëna, në mos funksionimin e komisionit në tërësi, po ashtu si kryetar i komisionit në asnjë rast nuk ka arritur t'i hedh poshtë konkluzionet profesionale të dhëna nga anëtarja e komisionit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi i Komisionit Disiplinor me nr. KDNSHC-05/047.2021 i datës 28.10.2021 i Policisë së Kosovës, është nxjerrë në pajtim me dispozitat e nenit 46, 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 8 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.897/2021, datë 28.12.2021.


Zyle Malaku GOJNOVCI
Procesmbajtëse


Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve në Policinë e Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

